



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

**BALANCA VJETORE E ENERGJISË
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2013**

**GODIŠNJI ENERGETSKI BALANS
REPUBLIKE KOSOVA ZA 2013. GODINU**

**ANNUAL ENERGY BALANCE OF
REPUBLIC OF KOSOVO FOR THE YEAR 2013**

Prishtinë, 2014



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

**BALANCA VJETORE E ENERGIJË
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2013**

Prishtinë, 2014

Ky dokument është përgatitur nga Divizioni i Politikave të Energjisë në MZHE, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e ngushtë të entiteteve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr.07/2011 Mbi Rregullat për Balancën e Energjisë.

Përmbajtja

Shkurtesat

Përmbledhje ekzekutive

1. Balanca vjetore e energjisë për vitin 2013	1
1.1. Burimet primare	1
1.1.1. Thëngjilli	2
1.1.2. Produktet e naftës	3
1.1.3. Biomasa (dru zjarri)	4
1.1.4. Energjia elektrike	4
1.1.5. Hidroenergja	4
1.1.6. Energjia e erës	4
1.1.7. Energjia solare	4
1.1.8. Biokarburantet	4
1.2. Konsumi final i energjisë	5
1.2.1. Konsumi final i thëngjillit	7
1.2.2. Konsumi final i produkteve të naftës	8
1.2.3. Konsumi final i energjisë elektrike	9
1.2.4. Konsumi final i ngrohjes së përfituar	10
1.3. Konsumi i energjisë në sektorin e industrisë	10
1.3.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë	10
1.3.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e industrisë	11
1.3.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e industrisë	12
1.3.4. Konsumi i energjisë elektrike në sektorin e industrisë	13
1.3.5. Pjesëmarrja e nënsektorëve të industrisë në konsumin e energjisë.....	14
1.4. Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërisë	15
1.4.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë	15
1.4.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e amvisërisë	17
1.4.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë	18
1.5. Konsumi i energjisë në sektorin e shërbimeve	19
1.5.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e shërbimeve	19
1.5.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e shërbimeve	20
1.5.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e shërbimeve	20

1.6. Konsumi i energjisë në sektorin e transportit	21
1.6.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e transportit	21
1.7. Konsumi i energjisë në sektorin e bujqësisë	22
1.7.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e bujqësisë	22
1.7.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e bujqësisë	23
1.7.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e bujqësisë	24
1.8. Mbulimi i kërkesës me energji në të gjithë sektorët.....	25
1.8.1. Furnizimi me thëngjill (lignit)	25
1.8.2. Furnizimi me energji elektrike	25
1.8.3. Furnizimi me produkte të naftës	26
1.9. Indikatorët e energjisë	26
1.10. Ndotja e mjedisit.....	27
1.10.1. Ndikimi i termocentraleve në ndotjen e mjedisit.....	27
 S H T O J C A T	 28
Shtojca 1. Karakteristikat e sistemit energjetik të Kosovës	29
Shtojca 2. Karakteristikat e burimeve energjetike dhe konvertimi i njësive	30
Shtojca 3. Balanca vjetore e energjisë për vitin 2012	32

Shkurtesat

MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
KOSTT sh.a	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
KEK sh.a	Korporata Energjetike e Kosovës
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
APK	Agjencioni Pyjor i Kosovës
KE	Komuniteti i Energjisë
REKOS	Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011
EUROSTAT	Enti i Statistikave i Komunitetit Evropian
CRES	Qendra për burime të ripërtëritshme dhe kursim të energjisë, Athinë-Greqi
AIE	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë
GLN	Gazi i Lëngëzuar i Naftës
TC	Termocentral
HC	Hydrocentral
GWh	Giga Vat Orë
GW	Giga Vat
MWh	Mega Vat Orë
MW	Mega Vat
BRE	Burime të Ripërtëritshme të Energjisë
BPV	Bruto Produkti Vendor
CO	Monoksid i karbonit
VOC	Përbërje organike lehtë e avullueshme
NO _x	Oksidet e azotit- NO dhe NO ₂
CO ₂	Dioksid i karbonit
SO ₂	Dioksid i sulfurit
ktoe	Kilo ton oil ekuivalent

Përmbledhje ekzekutive

“Balanca Vjetore e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2013” është përgatitur nga Divizioni për Politika të Energjisë, në kuadër të Departamentit për Energji në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik.

Balanca Vjetore e Energjisë e Republikës së Kosovës për vitin 2013 është përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr.03/L-184 për Energjinë dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2011 Mbi Rregullat për Balancat e Energjisë.

Në këtë dokument pasqyrohen rrjedhat fizike të energjisë të të gjitha llojeve dhe burimeve që janë përdorur në Kosovë gjatë vitit 2013.

Të dhënat janë grumbulluar nga entitetet si në vijim:

- Agjencia e Statistikave të Kosovës - të dhënat demografike dhe sociale, të dhënat për importin dhe eksportin e të gjitha lëndëve djegëse;
- Korporata Energjetike e Kosovës(KEK sh. a) - të dhënat për thëngjillin (prodhimi, furnizimi dhe stoqet), si dhe të dhënat për konsumin e energjisë elektrike;
- Operator i Sistemit, Transmisioni dhe Tregu sh.a (KOSTT) - të dhëna periodike mujore, si dhe vjetore të balancës elektroenergjetike;
- “Kosova Thëngjilli” sh.a- të dhënat për tregtimin e thëngjillit të njomë dhe të terur, të nxjerrë nga mihjet në Kosovë;
- Ndërmarrjet e ngrohjeve qendrore- të dhënat për rrjedhat energjetike në ndërmarrjet e ngrohjes;
- MTI- të dhënat e përpunuara për produktet e naftës.

Në këtë dokument analiza e konsumit të energjisë është bazuar në anketat dhe studimet e zhvilluara. Ekstrapolimi i këtyre të dhënave është bazuar në indikatorët relevantë të zhvillimit, siç janë ata demografikë, socialë dhe ekonomikë.

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar, sistemuar dhe paraqitur sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2011 Mbi Rregullat për Balancat e Energjisë.

1. Balanca Vjetore e Energjisë për vitin 2013

Pjesët kryesore të “Balancës Vjetore të Energjisë për vitin 2013” janë: burimet primare, ku përfshihen prodhimi, përfitimi, importi, eksporti dhe stoku, si dhe konsumi i këtyre produkteve të energjisë. Të dy këto pjesë do të analizohen në vijim.

1.1. Burimet primare të energjisë

Struktura e energjisë primare të konsumuar në Kosovë në vitin 2013 nuk ka ndryshuar në krahasim me vitin 2012. Atë e përbëjnë: thëngjilli, produktet e naftës (benzina, nafta, mazuti, kerozina dhe gazi i lëngëzuar i naftës-GLN), biomasa, hidroenergji, energjia e erës, energjia solare dhe biokarburantet. Energjia elektrike trajtohet si burim primar vetëm për sasinë e importit dhe eksportit. Kjo qasje është e bazuar në metodologjinë e EUROSTAT-it.

Siç vërehet në Tabela 1 sasia e përgjithshme (bruto) e energjisë në dispozicion për shfrytëzim (konsum) në vitin 2013 ka qenë 2392.20 ktoe. Krahasuar më 2012 ka pasur një rritje prej 2 %.

Tabela 1. Pasqyra e sasisë së energjisë së burimeve (produkteve) primare energjetike në dispozicion (ktoe)

Burimet e energjisë	2012	2013
Thëngjill	1528.10	1552.16
Produkte naftë	560.65	579.32
Biomasë	247.49	247.65
Hidroenergji	8.22	12.32
Energji solare	0.69	0.76
Energjia e erës	0.00	0.00
Biokarburante	0.00	0.00
Totali	2345.15	2392.20

Siç shihet nga Tabela 1 sasia në dispozicion e thëngjillit ka pasur një rritje në krahasim me 2012 për 1.6%, po ashtu sasia në dispozicion e produkteve të naftës ka pësuar një rritje në krahasim me vitin 2012 për 3.3%.

Të dhënat për sasinë e energjisë në dispozicion nga druri i zjarrit (biomasës) për vitin 2013 janë të bazuara në rezultatet e studimit të biomasës e kontraktuar nga Komuniteti i Energjisë realizuar nga CRES, në vitin 2011, të ekstrapoluar në bazë të rritjes së numrit të amvisërive dhe BPV-së për vitin 2013. Kjo bazohet në faktin se druri përdoret kryesisht për nevoja të ngrohjes së ekonomive familjare dhe rritja e numrit të ekonomive familjare ndikon në rritjen e hapësirave ngrohëse dhe rrjedhimisht rritjen proporcionale të konsumit të këtij produkti energjetik.




Figura 1. Pjesëmarrja e burimeve primare në dispozicion (%)

1.1.1. Thëngjilli

Sasia e thëngjillit në dispozicion për vitin 2013 ka qenë 1552.16 ktoe. Në Tabelën 2 janë paraqitur të dhënat për sasinë e energjisë në dispozicion nga thëngjilli.

Tabela 2. Pasqyra e sasisë së thëngjillit si burim primar në dispozicion (ktoe)

Thëngjill	2012	2013
Antracit	23.05	0.00
Thëngjill bituminoz dhe tjera	15.77	10.26
Thëngjill guri për koks	0.00	0.00
Linjit	1488.46	1541.38
Koks dhe gjysmë koks	0.42	0.07
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.00	0.02
Katran	0.00	0.00
Torfë	0.40	0.44
Totali i thëngjillit	1528.10	1552.16




Figura 2. Pasqyra e sasisë së thëngjillit si burim primar në dispozicion (ktoe)

Nga Figura 2 shihet se linjiti është produkti dominues me pjesëmarrje prej 99.3% në totalin e thëngjillit si burim primar në dispozicion, i pasuar nga thëngjilli bituminoz me 0.7%. Kosova posedon vetëm rezerva linjiti dhe jo edhe lloje të tjera të thëngjillit. Nevojat për lloje tjera të thëngjillit janë plotësuar nga importi.

1.1.2. Produktet e naftës

Në Kosovë nuk nxirret naftë po ashtu nuk rafinohet nafta e papërpunuar bruto. Të gjitha nevojat për produkte nafte mbulohen nga importi. Importi i produkteve të naftës për vitin 2013 ka qenë 579.32 ktoe. Krahasuar me vitin 2012 ka pasur një rritje prej 3.3%. Në Tabelën 3 janë paraqitur të dhënat për sasinë e energjisë në dispozicion nga produktet e naftës.

Tabela 3. Pasqyra e sasisë së produkteve të naftës (ktoe)

Produktet e naftës	2012	2013
Benzinë	71.51	66.77
Gazoil	0.00	0.00
Kerozinë	0.00	0.00
Kerozinë (Jetfuel)	14.29	14.99
Vajra të rënda/mazuti	46.58	36.08
Naftë	307.84	317.94
GLN	37.53	39.68
Koks nafte	43.68	61.93
Produkte tjera nafte	0.00	0.00
Mbetje nafte	0.00	0.00
Bitumen	34.00	37.52
Vajrat lubrifikante	5.22	4.41
Totali	560.65	579.32




Figura 3. Pjesëmarrja e produkteve të naftës si burime primare në dispozicion (%)

Nga Figura 3 shihet që pjesëmarrja e naftës në vitin 2013 ka qenë më e larta nga të gjitha llojet tjera të produkteve të naftës. Nafta merr pjesë me 54.9% në totalin e sasisë së produkteve të naftës në dispozicion, e pasuar nga benzina me 11.5%, koks naftë 10.7%, GLN 6.8%, bitumeni 6.5%, mazuti 6.2%, etj.

1.1.3. Biomasa (dru zjarri)

Sasia e konsumuar e druve të zjarrit në vitin 2013 është vlerësuar të jetë 247.65 ktoe. Krahasuar me 2012 kemi një rritje prej 0.06% që i korrespondon edhe rritjes së numrit të ekonomive familjare.

Të dhënat bazike për konsumin e drurit janë marrë nga studimi për konsumin e biomasës "Studimi për konsumin e biomasës për qëllime energjetike në Komunitetin e Energjisë" i realizuar nga CRES-i në vitin 2011, i kontraktuar nga Komuniteti i Energjisë.

1.1.4. Energjia elektrike

Bazuar në metodologjinë e EUROSTAT-it për paraqitjen e balancës së energjisë, energjia elektrike trajtohet si energji primare vetëm për sasinë e energjisë së importuar dhe asaj të eksportuar. Neto importi i kësaj energjie në vitin 2013 ka qenë -28.82 ktoe (import-eksport) që do të thotë se eksporti ka qenë më i lartë se sa importi.

1.1.5. Hidroenergja

Të dhënat për hidroenergjin janë siguruar nga KEDS-i dhe KOSTT-i. Këto të dhëna janë bazuar në sasinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet: HC "Ujmani", HCV "Lumbardhi", HCV "Radavci", HCV "Dikanci" dhe HCV "Burimi". Sasia e hidroenergjisë e prodhuar në hidrocentrale në vitin 2013 ka qenë 12.32 ktoe.

1.1.6. Energjia e erës

Në vitin 2013 nuk ka pasur gjenerim të energjisë elektrike nga era.

1.1.7. Energjia solare

Sasia e energjisë solare për vitin 2013 është vlerësuar mbi bazën e trendëve të viteve paraprake dhe ka rezultuar të jetë 0.76 ktoe.

1.1.8. Biokarburantet

Në vitin 2013 nuk është evidentuar import i biokarburanteve. Po ashtu nuk kemi të dhëna për prodhimin e këtij produkti energjetik.

1.2. Konsumi final i energjisë

Të dhënat për sasinë e energjisë së konsumuar për vitin 2013¹ janë bazuar në hulumtimet e realizuara me anketa në të gjithë sektorët ekonomik. Këto hulumtime janë zhvilluar përgjatë pesë viteve të kaluara (2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013), ndërsa vlerësimet janë bërë mbi bazën e analizës së trendeve të tri viteve të fundit, duke e ndërlidhur këtë edhe me indikatorë të përshtatshëm që kanë ndikim direkt në konsum të energjisë, siç janë: indikatorët ekonomik, demografik etj. Të dhënat e konsumit për biomasën janë marrë nga rezultatet e anketës për konsumin e biomasës në sektorët e amvisërisë, shërbimeve, bujqësisë dhe industrisë, projekt i kontraktuar nga Komuniteti i Energjisë në vitin 2011, ndërsa konsumi për vitin 2013 është ekstrapoluar për rritjen e numrit të amvisërive 0.68% rritje vjetore dhe rritjen e BPV-së 3.2%².

Sasia e konsumit të energjisë nëpër sektorë është paraqitur në tabelën 4.

Tabela 4. Pasqyra e pjesëmarrjes së gjithë sektorëve në konsumin final energjetik (ktoe)

Sektorët ekonomik	2012	2013
Sektori i industrisë	272.98	266.63
Sektori i amvisërisë	473.73	495.52
Sektori i shërbimeve	117.09	118.79
Sektori i bujqësisë	19.85	29.34
Sektori i transportit	342.65	328.52
Totali	1226.30	1238.80

Nga Tabela 4 shihet se konsumi final i energjisë për vitin 2013 ka qenë 1238.80 ktoe, në krahasim me vitin 2012 ka pasur një rritje prej 1%. Sektori me konsumin më të madh të energjisë për vitin 2013 është amvisëria me një sasi të energjisë prej 495.52 ktoe, ose 40% të konsumit total. Pas sektorit të amvisërisë vjen sektori i transportit me një sasi të energjisë prej 328.52 ktoe, ose 26.5%. Sektori i industrisë ka konsumuar energji në sasi prej 266.63 ktoe, ose 21.5%. Sasia e konsumit të energjisë të sektorit të shërbimeve është 118.79 ktoe, ose 9.6%. Sektori që ka konsumuar më së paku energji është ai i bujqësisë me një sasi prej 29.34 ktoe, ose 2.4% të konsumit të përgjithshëm.

¹“Konsumi i energjisë në Kosovë”, realizuar nga Instituti Riinvest në vitin 2009,

“Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e industrisë dhe mundësia e përmirësimit të eficiencës”, realizuar nga MPR GROUP në vitin 2010,

“Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e amvisërisë dhe mundësia e përmirësimit të eficiencës”-realizuar nga Instituti “Intech” në vitin 2011,

“Studimi mbi shpërndarjen e konsumit të energjisë në sektorin e shërbimeve”-realizuar nga Studio projektuese “Links 4” në vitin 2012,

“Studim për konsumin e biomasës për qëllime energjetike në Komunitetin e Energjisë”, realizuar nga CRES në vitin 2011;

“Studimi mbi konsumin e energjisë në sektorin e bujqësisë”, realizuar nga “Intech” në vitin 2013

²Ministria e Zhvillimit Ekonomik




Figura 4. Pjesëmarrja e sektorëve të ekonomisë në konsumin e energjisë (%)

Konsumi final i energjisë për qëllime jo energjetike për vitin 2013 ka qenë 42.37 ktoe. Torfa është lloji i vetëm i thëngjillit, i cili është konsumuar për qëllime jo energjetike në sasi prej 0.44 ktoe. Ndërsa nën-produktet e naftës, bitumeni dhe vajrat lubrifikante janë konsumuar për qëllime jo energjetike në vitin 2013 në sasi prej 41.93 ktoe. Në vazhdim paraqitet konsumi final jo energjetik dhe konsumi final i energjisë. Në krahasim me vitin 2012 kemi një rritje prej 6.9% të konsumit të produkteve energjetike për qëllime jo energjetike.

Tabela 5. Konsumi final jo energjetik(ktoe)

Sektorët ekonomik	2012	2013
Industria kimike	0.40	0.44
Sektorët tjerë	39.22	41.93
Totali	39.62	42.37

Në Tabelën 6. paraqitet gjendja e sasisë së konsumit final të energjisë sipas llojeve të produkteve energjetike.

Tabela 6 . Pasqyra e konsumit final të të gjitha burimeve të energjisë (ktoe)

Burimi	2012	2013
Thëngjill	68.58	55.95
Produkte naftë	561.18	573.58
Biomasa	247.50	247.65
Biokarburante	0.00	0.00
Energji elektrike	384.54	399.57
Energji solare	0.69	0.76
Ngrohje e përfituar	3.44	3.67
Totali	1265.92	1281.17




Figura 5. Pjesëmarrja në konsum të të gjitha burimeve të energjisë (%)

Produkti energjetik më i konsumuari gjatë vitit 2013 ka qenë produkti i derivateve të naftës, në sasinë prej 573.58 ktoe që përbën 44.8% të konsumit total të të gjitha produkteve energjetike. Energjia elektrike është produkti i dytë energjetik më i konsumuari në sasi prej 399.57 ktoe, ose 31.2% të konsumit të përgjithshëm (total). Biomasa (kryesisht dru zjarri) është konsumuar në sasi prej 247.65 ktoe, ose 19.3% në konsumin e përgjithshëm. Thëngjilli është konsumuar në sasinë prej 55.95 ktoe, ose 4.4% të konsumit të përgjithshëm. Sasia e energjisë së ngrohjes së përfuar është 3.67 ktoe, ose 0.3% të sasisë së përgjithshme të energjisë së konsumuar. Energjia solare është vlerësuar të jetë konsumuar në sasinë prej 0.76 ktoe, ose 0.1% të konsumit total të të gjitha burimeve të energjisë.

1.2.1. Konsumi final i thëngjillit

Konsumi final i llojeve të thëngjillit paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 7. Pasqyra e konsumit final të thëngjillit (ktoe)

Thëngjill	2012	2013
Antracit	23.05	0.00
Thëngjill bituminoz dhe tjera	15.77	10.26
Thëngjill guri për koks	0.00	0.00
Linjit	28.94	36.17
Koks dhe gjysmë koks	0.42	0.07
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrëm	0.00	0.02
Katran	0.00	0.00
Torfë	0.40	0.44
Totali	68.58	46.95




Figura 6. Pasqyra e konsumit të thëngjillit (%)

Nga Tabela 7 dhe Figura 6 shihet se linjiti ishte lloji thëngjillit që më së shumti është konsumuar në vitin 2013, në sasi prej 36.17 ktoe, ose 77% të konsumit total. Sasia e thëngjillit bituminoz është konsumuar 10.26 ktoe ose 21.9% të konsumit total. Torfa është konsumuar në sasi prej 0.44 ktoe, ose 0.9%, por kjo sasi e torfës është konsumuar për qëllime jo energjetike. Koks dhe gjysëm koks është konsumuar 0.07 ktoe ose 0.1% si dhe brikete të thëngjillit te murrmë 0.02 ktoe ose 0.04% të konsumit total. Rënja e konsumit të thëngjillit nga viti 2012 shpjegohet me zvogëlimin e importit të antracitit dhe thëngjillit bituminoz.

1.2.2. Konsumi final i produkteve të naftës

Në vijim paraqitet konsumi final i të gjitha produkteve të naftës:

Tabela 8. Pasqyra e konsumit final të produkteve të naftës (ktoe)

Produkte nafte	2012	2013
Benzinë	71.51	66.77
Gazoil	0.00	0.00
Kerozinë	0.00	0.00
Kerozinë (Jetfuel)	14.29	14.99
Vajra te rënda/mazuti	36.32	27.25
Naftë	311.73	318.97
GLN	44.44	41.68
Koks nafte	43.68	61.93
Produkte tjera nafte	0.00	0.00
Mbetje nafte	0	0.00
Bitumen	34.00	37.52
Vajrat lubrifikante	5.22	4.41
Totali	561.18	573.52




Figura 7. Pasqyra e konsumit të produkteve të naftës (%)

Siç shihet nga Tabela 8 nafta është nën-produkti më i konsumuar në vitin 2013 me një pjesëmarrje prej 318.97 ktoe, ose 55.6% e konsumit total të derivateve të naftës, pasuar nga benzina me 66.77 ktoe, ose 11.6%, koks nafte me 61.93 ktoe, ose 10.8% GLN me 41.68 ktoe, ose 7.3%, bitumeni me 37.52 ktoe ose 6.5%, por kjo sasi e bitumenit konsumohet për qëllime jo energjetike (shih tabelën 7), mazuti me 27.25 ktoe, ose 4.8%, dhe kerozinë (Jetfuel) 14.99 ktoe, ose 2.6% të konsumit total të derivateve të naftës.

1.2.3 Konsumi final i energjisë elektrike

Në vitin 2013 konsumi i energjisë elektrike ka qenë 399.57 ktoe në krahasim me vitin 2012 ka pasur një rritje prej 3.9%. Në tabelën në vijim paraqitet konsumi i energjisë elektrike në të gjithë sektorët ekonomik.

Tabela 9. Pasqyra e konsumit të energjisë elektrike(ktoe)

Sektori	2012	2013
Industria	107.92	108.00
Transporti	0.00	0.00
Amvisëria	210.15	229.36
Bujqësia	6.66	1.21
Shërbimet	59.81	61.00
Totali	384.54	399.57




Figura 8. Pjesëmarrja e konsumit të energjisë elektrike në sektorët ekonomikë (%)

Siç shihet nga Tabela 9, sektori i amvisërisë është sektori me konsumin më të madh të energjisë elektrike prej 229.36 ktoe, ose 57.4% të konsumit total të energjisë elektrike. Sektori i dytë që ka konsumuar më së shumti energji elektrike është sektori i industrisë me konsum prej 108 ktoe, ose 27% të sasisë së përgjithshme të kësaj energjie. Më pas vjen sektori i shërbimeve me konsum të energjisë elektrike prej 61 ktoe, ose 15.3% dhe në fund sektori i bujqësisë me konsum të energjisë elektrike prej 1.21 ktoe, ose 0.3% të konsumit të përgjithshëm të energjisë elektrike.

1.2.4. Konsumi final i ngrohjes së përfituar

Konsumi total i ngrohjes së përfituar për vitin 2013 ka qenë 3.67 ktoe, ose një rritje prej 6.7% krahasuar me vitin 2012. Amvisëria është konsumatori kryesor me një konsum prej 2.38 ktoe, ose 65% të konsumit total të ngrohjes së përfituar, pasuar nga sektori i shërbimeve me konsum prej 1.28 ktoe, ose 35%.

Tabela 10. Pasqyra e konsumit të ngrohjes së përfituar në të gjithë sektorët ekonomik shprehur në ktoe

Sektori	2012	2013
Industria	0.00	0.00
Transporti	0.00	0.00
Amvisëria	2.24	2.38
Bujqësia	0.00	0.00
Shërbimet	1.21	1.28
Totali	3.44	3.67

1.3. Konsumi i energjisë në sektorin e industrisë

1.3.1. Konsumi i të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë

Konsumi i energjisë (i të gjitha produkteve energjetike), në sektorin e industrisë të vitit 2013 ka qenë 266.63 ktoe. Ka pasur një ulje prej -2.3% krahasuar me vitin 2012

Tabela 11. Pasqyra e konsumit të të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë (ktoe)

Produkti energjetik	2012	2013
Thëngjill	49.36	30.47
Produkte nafte	104.41	116.51
Biomasa	11.28	11.64
Energji elektrike	107.92	108.00
Totali	272.98	266.63

Produktet e naftës janë produktet më të konsumuara në sektorin e industrisë, me një sasi prej 116.51 ktoe, ose 43.7%, pasuar nga energjia elektrike me 108 ktoe, ose 40.5%, thëngjilli me 30.47 ktoe, ose 11.4% dhe biomasa me 11.64 ktoe, ose 4.4% të konsumit të përgjithshëm të energjisë në sektorin e industrisë.




Figura 9. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e industrisë (%)

1.3.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e industrisë

Në Tabelën 12 shihet pasqyra e konsumit e të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e industrisë. Pjesëmarrja e linjtit për vitin 2013 është me 20.22 ktoe, ose me 66.4%, thëngjilli bituminoz me thëngjill tjetër me 10.18 ktoe, ose 33.4% dhe koks dhe gjysmë koks me 0.07 ktoe, ose 0.2%.

Tabela në vijim paraqet konsumin e secilit lloj të thëngjillit në sektorin e industrisë.

Tabela 12. Pasqyra e konsumit e të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e industrisë (ktoe)

Thëngjill	2012	2013
Antracit	23.05	0.00
Thëngjill bituminoz dhe tjera	15.65	10.18
Thëngjill guri për koks	0.00	0.00
Linjit	10.25	20.22
Koks dhe gjysmë koks	0.42	0.07
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.00	0.00
Katran	0.00	0.00
Torfë	0.00	0.00
Totali	49.36	30.47




Figura 10. Pasqyra e konsumit të të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e industrisë (%)

1.3.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e industrisë

Në Tabelën 13 shihet se në konsumin e derivateve të naftës në sektorin e industrisë në vitin 2013 prinë koks nafte me pjesëmarrjen prej 53.2%e totalit të produkteve të naftës të konsumuar në këtë sektor, pasuar nga nafta(dizel) me 21.7%,mazuti me 16.4%, GLN me 8.3% dhe benzina me 0.5% të konsumit total të derivateve të naftës në sektorin e industrisë.

Tabela 13. Pasqyra e konsumit të produkteve të naftës në sektorin e industrisë(ktoe)

Produktet e naftës	2012	2013
Benzinë	0.55	0.53
Gazoil	0.00	0.00
Kerozinë	0.00	0.00
Kerozinë (Jet fuel)	0.00	0.00
Vajra të rënda / mazut	25.00	19.07
Naftë	25.11	25.26
GLN	10.07	9.72
Koks nafte	43.68	61.93
Produkte tjera nafte	0.00	0.00
Mbetje nafte	0.00	0.00
Bitumen	0.00	0.00
Totali	104.41	116.51




Figura 11. Pjesëmarrja në konsum e produkteve të naftës në sektorin e industrisë (%)

Sektori i industrisë përbëhet prej degëve industriale si në vijim: industria e hekurit dhe e çelikut, industria e metaleve jo ferore, industria kimike, industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore, industria e nxjerrjes së xeheve, industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit, industria e tekstilit, lëkurës dhe veshmbathjes, industria e letrës dhe stampimit, inxhinieringut dhe industritë e tjera të jometaleve.

1.3.4 Konsumi i energjisë elektrike në sektorin e industrisë

Konsumi total i energjisë elektrike në sektorin e industrisë për vitin 2013 ka qenë 108 ktoe. Industria e hekurit dhe e çelikut është dega e industrisë me konsumin më të lartë të energjisë elektrike në sasi prej 43.96 ktoe, ose 40.7% të konsumit total të energjisë elektrike në sektorin e industrisë, pasuar nga industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit me 40.40 ktoe, ose 37.4%, industritë tjera me 15.26 ktoe, ose 14.1%, industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore me 5.28 ktoe, ose 4.9% dhe industria e metaleve jo ferore 1.40 ktoe, ose 1.3%.

Tabela 14. Pasqyra e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e industrisë (ktoe)

Nësektorët e industrisë	2012	2013
Industria e hekurit dhe e çelikut	43.93	43.96
Industria e metaleve joferore	1.39	1.40
Industria kimike	0.24	0.24
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore	5.28	5.28
Industria e nxjerrjes së xeheve	1.20	1.20
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit	40.37	40.40
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshmbathjes	0.09	0.09
Industria e letrës dhe stampimit	0.16	0.16
Inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve	0.01	0.01
Industritë tjera	15.24	15.26
Totali	107.92	108.00




Figura 12. Pjesëmarrja e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e industrisë (%)

1.3.5 Pjesëmarrja e degëve të industrisë në konsumin e energjisë

Konsumi i energjisë në industrinë e hekurit dhe çelikut 77.66 ktoe ose 29.1% e sasisë së konsumit të energjisë në gjithë sektorin e industrisë. Pas degës së industrisë së hekurit dhe çelikut vjen industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore, me një sasi konsumi prej 67.67 ktoe, ose 25.4% të totalit të energjisë së konsumuar nga sektori i industrisë. Një konsumator i madh energjetik është edhe industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit që konsumon sasinë prej 55.98 ktoe, ose 21% të konsumit total energjetik në sektorin e industrisë. Industria e tjera kanë konsumuar sasinë prej 36.06 ktoe, ose 13.5% të konsumit total të sektorit të industrisë. Industritë e metaleve jo ferrore kanë konsumuar së bashku sasinë e energjisë prej 25.55 ktoe, ose 9.6% të konsumit total të energjisë së shpenzuar nga sektori i industrisë. Metoda e vlerësimit bazohet në anketat e realizuar në vitin 2009 dhe 2010, duke u bazuar në përqindjet e pjesëmarrjes së degëve në totalin e produkteve energjetike që ka tërhequr sektori. Vlen të ceket se është e nevojshme që të zhvillohet studimi i ri i konsumit të energjisë në këtë sektor.

Tabela 15. Pasqyra e konsumit total të energjisë të nën sektorëve të industrisë (ktoe)

Degët e industrisë	2012	2013
Industria e hekurit dhe çelikut	85.31	77.66
Industria e metaleve joferrore	37.72	25.55
Industria kimike	1.56	1.46
Industria e xhamit, qeramikës dhe materialeve ndërtimore	55.64	67.67
Industria e nxjerrjes së xeheve	2.12	1.90
Industria e ushqimit, pijeve dhe duhanit	58.21	55.98
Industria e tekstilit, lëkurës dhe veshëmbathjes	0.13	0.09
Industria e letrës dhe stampimit	0.24	0.25
Inxhinieringu dhe industritë tjera të metaleve	0.01	0.01
Industritë tjera	32.02	36.06
Totali	272.98	266.63




Figura 13. Pasqyra e konsumit të energjisë të nënsektorëve të industrisë (%).

1.4. Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërisë

1.4.1. Konsumi i të gjitha produkteve energjetike në sektorin e amvisërisë

Energjia, e cila konsumohet nga sektori i amvisërisë shfrytëzohet për ngrohjen e hapësirave, kondicionimin e ajrit, ngrohjen e ujit sanitar, gatim, ndriçim dhe përdorim të pajisjeve elektrike për nevoja familjare dhe individuale.

Konsumi i energjisë në sektorin e amvisërisë për vitin 2013 ka qenë 495.52 ktoe. Ka pasur një rritje të konsumit të energjisë prej 4.6% krahasuar me vitin 2012.

Tabela16. Pasqyra e konsumit të të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë (ktoe)

Burimi	2012	2013
Thëngjill	16.10	18.24
Produkte nafte	17.79	16.51
Biomasë	227.25	228.80
Energji elektrike	210.15	229.36
Energji solare	0.21	0.23
Ngrohje e përfituar	2.24	2.38
Totali	473.73	495.52




Figura 14. Pasqyra e konsumit e të gjitha burimeve të energjisë në sektorin e amvisërisë (%)

Produkti energjetik më i konsumuar në sektorin e amvisërisë për vitin 2013 është energjia elektrike me një konsum prej 229.36 ktoe, ose 46.3% të konsumit total të energjisë së konsumuar në këtë sektor. Pas energjisë elektrike vjen biomasa, e cila është konsumuar në sasi prej 228.80 ktoe, me një pjesëmarrje prej 46.2% të konsumit total. Sasia e energjisë nga thëngjilli ka qenë 18.24 ktoe, ose 3.7 % e konsumit total të energjisë. Produktet e naftës janë konsumuar në sasinë prej 16.51 ktoe, që është 3.3 % e konsumit total. Ngrohja e përfituar është konsumuar në sasinë e energjisë prej 2.38 ktoe, ose 0.5% e konsumit total të energjisë. Pjesëmarrja e ulët e ngrohjes së përfituar në konsumin total të energjisë të sektorit të amvisërisë ndërlihet me:

- Reduktimet kolektive të konsumatorëve të ngrrohtoreve të qytetit, sidomos konsumatorëve të ngrrohtores "Termokos" e Prishtinës, si pasojë e masave ndaj konsumatorëve që nuk kanë paguar energjinë, dhe
- Mungesa e lëndës djegëse për ngrrohje (mazutit).

Pra ka pasur zvogëlim të imponuar të konsumit të energjisë së ngrohjes së përfituar.

1.4.2. Konsumi i thëngjillit në sektorin e amvisërisë

Në Tabelën 17 shihet se linjiti është lloji i kryesor i thëngjillit të konsumuar në sektorin e amvisërisë në sasi energjie prej 18.22 ktoe, ose 99.9%, i pasuar nga brikete të thëngjillit të murrmë me 0.02 ktoe ose 0.1% të konsumit total të thëngjillit.

Tabela17. Pasqyra e konsumit të të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e amvisërisë shprehur në ktoe

Thëngjill	2012	2013
Antracit	0.00	0.00
Thëngjill bituminoz dhe tjera	0.00	0.00
Thëngjill guri për koks	0.00	0.00
Lignit/thëngjill i murrmë	16.10	18.22
Koks dhe gjysmë koks	0.00	0.00
Gaz thëngjilli, gaz uji etj.	0.00	0.00
Koks terpentinë nga katrani	0.00	0.00
Brikete të thëngjillit të murrmë	0.00	0.02
Katran	0.00	0.00
Torfë	0.00	0.00
Totali	16.10	18.24




Figura 15. Pasqyra e konsumit të të gjitha llojeve të thëngjillit në sektorin e amvisërisë (%)

Duhet cekur në këtë rast se jemi shërbyer vetëm me të dhënat administrative të KEK-ut, Divizionit të Thëngjillit dhe nuk janë bërë vlerësime të konsumit të thëngjillit nga mihjet private siç ka ndodhur viteve të kaluara.

1.4.3. Konsumi i produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë

Në Tabelën 18 është pasqyruar gjendja e konsumit të produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë. GLN është produkti energjetik më i konsumuar në kuadër të produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë në sasi energjie prej 8.94 ktoe, ose 54.2% të konsumit total, pasuar nga nafta me 4.36 ktoe, ose 26.4% dhe benzina me 3.20 ktoe, ose 19.4%.

Tabela18. Pasqyra e konsumit e të gjitha produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë(ktoe)

Produktet e naftës	2012	2013
Benzinë	3.43	3.20
Gazoil	0.00	0.00
Kerozinë	0.00	0.00
Kerozinë (Jetfuel)	0.00	0.00
Vajra të rënda /mazut	0.00	0.00
Naftë	4.34	4.36
GLN	10.02	8.94
Koks nafte	0.00	0.00
Produkte tjera nafte	0.00	0.00
Mbetje nafte	0.00	0.00
Bitumen	0.00	0.00
Totali	17.79	16.51




Figura 16. Pasqyra e konsumit e të gjitha produkteve të naftës në sektorin e amvisërisë (%)

1.5. Konsumi i energjisë në sektorin e shërbimeve

1.5.1. Konsumi i të gjitha produkteve energjetike në sektorin e shërbimeve

